

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

616-24-1840-2-1-5/C1424

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik ALKO - IMPEX -General Constuction -Sh.p.k.; N.T.SH. Krasniqi, NDUE PËRLLESHI (KOMPLEKSI ALKO-IMPEX), PRISHTINË, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Ofrimi i makinerisë shtesë për shërbimin e grumbullimit ,transportimit dhe deponimit të mbeturinave Komunale

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Ofrimi i makinerisë shtesë për shërbimin e grumbullimit ,transportimit dhe deponimit të mbeturinave Komunale

Nr.	Nr te prokrimit 616-24-1840-2-1-5 dhe me nr te brenshem 616 24 024 215
1	Ofrimi i makinerisë shtesë për shërbimin e grumbullimit ,transportimit dhe deponimit të mbeturinave Komunale

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi nga data që do të caktohet në planin e menagjimit dhe është valide 12 muaj nga ajo datë .

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **24** orë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në territorin e Komunës së Prishtinës

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është 1000,000.00Euro. (Njëmiljon Euro)

Duke qenë se në këtë Kontratë, në pajtim me dispozitat e nenit 52 pika 6 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092LPP-së dhe nenin 56 pika 11 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik nuk është përcaktuar ndonjë limit financiar dhe / ose sasi apo devijim i lejuar nga vlera e parashikuar e kontratës, Menaxheri i Kontrates duhet ta arsyetoj bindshëm tejkalimin e shpenzimit të vlerës së parashikuar të Kontratës në rast se vlera e parashikuar ndryshon në mënyrë substanciale.

Peshimi i artikuj-ve duhet bërë bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit. Menaxheri i Kontrates mbetet përgjegjëse që të dëshmojë në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të Autoritetit Kontraktues

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.






Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues				Për Kontraktuesin	
Drejtor I prokurimit		Zyrtari Kryesor Administrativ			
Emri:	Visar Shehu	Emri:	Përparim Rama	Emri:	IT/AR
Pozita:	Udhëheqës i Prokurimit	Pozita:	Kryetar i Komunës	Pozita:	DRFIDOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	04.04.2024	Data:		Data:	05.04.2024
Vula:				Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 “**Shërbimet**” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 “**Ofrues i shërbimeve**” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktuar pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrat me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke i ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbimë parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie të pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të pagujë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkakttoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbrojë dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë asetit të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit caktohet nga ZKA-ja.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është:100,000 Euro për kohëzgjatjen e periudhës prej 13 Muajve
		Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 12 MUAJ
Parimet të përgjithshme të pagesave	14.2	Kërkesat për pagese do të bëhen për shërbimet e performuara në baza mujore (ex post). Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për shërbimet e performuara ne baza mujore (ex post). Nuk ka pagese paraprake.
Afati i liferimit pas porosisë për furnizim apo ofrim të shërbimit	14.4	24 orë
Rezervat	14.5	N/A
Data e fillimit të implementimit të kontratës	14.6	3 ditë pas nënshkrimit të planit të menaxhimit.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo

		<p>ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>(ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <i>Inspektimi do te behet nga persona te caktuar nga ZKA.</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<p>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2, -, PRISHTINË,

Zyrtari përgjegjës i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 616-24-1840-2-1-5

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **Grup i Operatorëve Ekonomik ALKO - IMPEX -General Constuction - Sh.p.k.; N.T.SH. Krasniqi, NDUE PËRLLESHI (KOMPLEKSI ALKO-IMPEX), 10000, PRISHTINË, Kosovë**

E-mail: info@alkoimpex.com

Personi kontaktues: **Imer Ademi**

Telefoni: **045/511114**

Faxi:

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri 1.

Emri i kompanisë: **ALKO - IMPEX -General Constuction -Sh.p.k.**

Numri fiskal: **600115746**

Vend-Selia: **NDUE PËRLLESHI (KOMPLEKSI ALKO-IMPEX), 10000, PRISHTINË, Kosovë**

Partneri 2.

Emri i kompanisë: **N.T.SH. " Krasniqi"**

Numri fiskal: **600213194**

Vend-Selia: **KAÇANIK I VJETËR, 31, Kacanik, Kosovë**

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 616-24-1840-2-1-5

Titulli i kontratës: Ofrimi i makinerisë shtesë për shërbimin e grumbullimit ,transportimit dhe deponimit të mbeturinave Komunale

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Ofrimi i makinerisë shtesë për shërbimin e grumbullimit ,transportimit dhe deponimit të mbeturinave Komunale


3. Çmimi total i tenderit është:

65.80 EUR

Dhe në fjalë ~~[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]~~

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **120** nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

PARAMASA				
Nr.	PËSHKRIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH
1	<p>Ofrimi i shërbimit grumbullimit, deponimit dhe depozimit të mbeturinave, përmes kamionëve me specifikë të detajuar në specifikim e automjeteve. Në këtë pozicion janë të parapara këto aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Angazhimi i makinës dhe fuqisë punëtore për mbledhjen e mbeturinave nga kontejnerëve 1.1m³, shportave 120l apo 240l dhe llojeve tjera të kontejnerëve/tuasëve që shfrytëzohen nga ofruesi dhe bizneset për eliminimin e mbeturinave; -Pastrimi i sipërfaqes përreth pas zbratjes së shportave/kontejnerëve deri në 10m distancë në tërë perimetrim; -Transportimi i mbeturinave deri në deponi sanitare të menaxhuara nga KMDK dhe zbrazja e lamiionëve. <p>Verejftje:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Para fillimit të punëve Operatori Ekonomik duhet që makinëritve të shfrytëzuara ti vendos GPS dhe të mundësoj qasje të plotë në monitorimin e tyre; -Angazhimi i makinës dhe fuqisë punëtore bëhet pas pranimt të kërkesës nga organi mblëqës. Kërkesa realizohet së paku 12 orë para; -Operimi duhet të realizohet në kohën e përcaktuar; -Të gjitha kostot e transportit, mirëmbajtjes së makinës, deponimit të mbeturinave, angazhimit të stafit operativ (shofer, punëtor, kryepunëtor, dhe menaxher) duhet të parashihen në këtë pozicion; -Kalkulimi i punës bëhet konform sasisë së mbeturinave të dërguara në deponi, në bazë të raportëve të pranuar nga KMDK; -Mbledhja e mbeturinave nuk gëxon të realizohet jashtë territorit të Komunës së Prishtinës, përndryshe shkaktohet shkelje e rëndë e kontratës duke u konsideruar mashtrim; -Makinëria e shfrytëzuar duhet të jetë e pastër dhe punëtorët duhet të jenë të gjitha mjartet e punës dhe uniformë adekuata. 	ton	1	65
Totali A				65,00 €
4	<p>Ofrimi i shërbimit shërbues, dezinfektimit dhe larjes së një lokacioni të kontejnerëve duke përfshirë edhe larjen dhe dezinfektimin edhe të kontejnerëve që gjenden në atë lokacion. Në këtë pozicion janë të parapara këto aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Pastrimi detaj paraprak i kontejnerëve. Ky pastrim realizohet në bazën (autoparkun) e kompanisë. Larja në bazë është shumë e rëndësishme për të zvogëlluar kohën e nevojshme për interveinim; -Bartja e kontejnerëve të pastur nga baza deri tek lokacioni i planifikuar për tu pastruar, dhe tërheqja e kontejnerëve të papastër nga lokacioni në fjalë, respektivisht transportimi i tyre në bazë; -Pastrimi detaj i lokacionit duke përfshirë të gjitha hapat e parapara me përsëritim e aktiviteteve. Ky pastrim duhet të realizohet në bazë, mure, mbulesën metalike apo edhe në rrethet; -Verejftje: -Pastrimi i lokacionit nënkupton pastrimin e detajuar edhe të hapësirës përreth lokacionit të kontejnerëve, e cila mund të jetë ndodur nga rrjedhja e langleve të ndryshme nga mbeturinat; -Angazhimi i makinës dhe fuqisë punëtore bëhet pas pranimt të kërkesës nga organi mblëqës. Kërkesa realizohet së paku 12 orë para; -Operimi duhet të realizohet në kohën e përcaktuar; -Të gjitha kostot e transportit, mirëmbajtjes së makinës, furnizimit me detejant, ujë dhe elemente tjera, angazhimit të stafit operativ (shofer, punëtor, kryepunëtor, dhe menaxher) duhet të parashihen në këtë pozicion; -Pagesa llogaritet për një lokacion të kontejnerëve pa marrë parasysh përmasat dhe formën e lokacionit apo edhe numrin e kontejnerëve; -Makinëria e shfrytëzuar duhet të jetë e pastër dhe punëtorët duhet të jenë të gjitha mjartet e punës dhe uniformë adekuata. 	Copë	1	73
Totali B				73,00 €



REKAPITULLIM	
A - 90%	Çmimi total
B - 10%	€ 65,00
Çmimi total peshëtur	
€ 73,00	
Çmimi total peshëtur me TVSH	
€ 66,500	

Çmimi përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerëzohen në bazë të kësaj vlerë). Kjo është vlera e cila do të duhet të shënohet në Formularin e ofruesit dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR KRYERJEN E NEGOCIATAVE ²


Sipas Nenit 34 të Ligjit Nr. 04/L-042

Kjo listë duhet të plotësohet për SECILËN FAZË të negociatave dhe për SECILIN KANDIDAT TË KUALIFIKUAR të fuar për të marrë pjesë në negociatë

Lënda e negociatave	Nr i kandidatit [NE]	Informacioni i dhënë kandidatit	Emri		FAZA E NEGOCIATAVE [NI]	
			Propozimi nga kandidati	Pesha	Pikët (e peshuar)	Të marrë pjesë në fazën e ardhshme të negociatave Po/Jo
Ofrimi i makinerisë shtesë për shërbimin e grumbullimit ,transportimit dhe deponimit të mbeturinave komunale	Grup i Operatorëve Ekonomik ALKO - IMPEX -General Constuction " Sh.p.k; N.T.SH. Krasnoji, NDUE PËRLESHI (KOMPLEKSI ALKO-IMPEX), 10000, PRISHTINË.	Ofrimi i makinerisë shtesë për shërbimin e grumbullimit ,transportimit dhe deponimit të mbeturinave komunale				
Rezultati i negociatave	Komisioni i vlerësimit të bashku me OE negocuan çmimin për pozicionin e pare nga çmimi prej 65 euro në 64€uro ,ndërsa për pozicionin nr 2 nga çmimi 73 €uro në 70 €uro				Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve të ndryshuara apo të përfunduara	

Komisioni i vlerësimit
 Bashkim Sadiku
 Lumnije Hyseni
 Erveteje Zogaj

Operatori Ekonomik IMPEX-ALKO




² Të përdoret vetëm në raste të procedurës konkurruese me negociatë

PARAMASA ME CËMIME TE NEGOCIJARA

PËRSHIKIMI I PUNËVE

Nr.	Mësoja	Sasia	Cmimi në TVSH	Shuma me TVSH
A.				
1	ton	1	64	64.00 €
Totali A:				64.00 €
B.				
4	Copë	1	70	70.00 €
Totali B:				70.00 €

REZULTATUM	
A - 90%	Cmimi lokal
B - 10%	€ 64.00
Cmimi lokal peshuar	
	€ 70.00
Cmimi i përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlera). (Është e mundur që të shënohet në formulimin e ofertës dhe/ose të lexohet gjatë hapjes publike.	
	€ 64.60



SPECIFIKIMI I AKTIVITETEVE

AKTIVITETET FILLESTARE

Regjistrimi i makinerisë, kontrollimi i rregullt teknik, mirëmbajtja teknike e tyre, vendosja e GPS-ve për monitorim dhe pastrimi i rregullt i makinerisë

Operatori ekonomik i cili shpërblehet me kontratë para fillimit të punimeve, obligohet që makinerinë ta ketë në gjendje të rregullt dhe të gatshme për operim. Gjithashtu gjatë ekzekutimit të punimeve obligohet që t'a pastroj makinerinë tërë kohën, në mënyrë që të ofrohet një shërbim i cilësisë së lartë duke mos shkaktuar ndotje dhe duke pasur një makineri me dukje serioze.

Para fillimit të punëve, OE obligohet që ti vendosë GPS kamionëve dhe t'i siguroj qasje ekipit mbikëqyrës për monitorimin e rregullt të tyre. Gjithashtu, obligohet t'i ofroj të gjitha dëshmitë rreth lokacionit të kamionëve në kohë të caktuar.

Makineria e shfrytëzuar nuk guxon të ketë probleme teknike si rrjedhje të vajrave dhe papastërtive tjera të lëngëshme. Çdo makinë e shfrytëzuar duhet ti ket elementet sinjalizuese konform standardeve dhe duhe të ketë kontrollimin e rregullt teknik.

OE obligohet që të shfrytëzoj lexuesit për skanimin e cipave RFID, lexuesit do të pranohen nga AK. Cdo dëmtim eventual i lexuesve do të kompenzohet nga vet OE.

Makineria e shfrytëzuar për këtë aktivitet nuk guxon të shfrytëzohet për ndonjë qëllim tjetër nga OE. Çdo lëvizje e makinerisë, duhet të bëhet në bazë të planit operativ të pranuar nga ekipi menaxhues. Lëvizjet jashtë këtij plani duhet të aprovohen nga menaxheri i kontratës.

Në rast se OE nuk respekton kushtet e kësaj kontrate dhe makinerinë e shfrytëzon për të kryer ndonjë punë tjetër jashtë atyre të parapara me këtë kontratë, apo nëse shfrytëzon makinerinë për të kryer shërbim ndonjë personi juridik apo fizik, kompanisë do ti shqiptohet vërejtje për mos respektim të kushteve të kësaj kontrate. Mosrespektimi i kushteve të kësaj kontrate do të konsiderohet shkelje e kontratës dhe do të merren të gjitha hapat e parapara në bazë të LPP deri në shkëputje të kontratës.

Sigurimi i punëtorëve, përgatitja e punëtorëve me uniforma adekuate dhe mjete të vogla pune

Operatori Ekonomik i shpërblyer me kontratë obligohet që punëtorët që i angazhon ti ketë të siguruar. Gjithashtu, obligohet që secilin punëtor t'a obligoj të mbajë veshur uniformën adekuate për ekzekutimin e punës. Gjatë operimit, punëtorët duhet ti kenë edhe mjetet e vogla të punës, përmes të cilave pastrojnë sipërfaqen përreth kontejnerëve.

Ofrimi i shërbimit

Mbledhja e mbeturinave nga kontejnerët publik

Mbledhja e mbeturinave nga kontejnerët publik realizohet me tre lloje të makinerisë, duke pasur parasysh që kemi rrugë me gjerësi të ndryshme në qytet, në të cilat kemi të vendosur kontejner publik, megjithëse ofrimi i këtij shërbimi kryesisht parashihet të realizohet përmes kamionëve më të mëdhenj (5-7ton dhe 9-11ton). Ofrimi i këtij shërbimi do të realizohet në bazë të planit të pranuar minimum 12 orë paraprakisht.

Ky shërbim parashihet të realizohet 24/7 andaj edhe Operatorit duhet të jetë i gatshëm që të ofroj makinerinë gjatë gjithë kohës.

Pas zbrazjes së kontejnerëve, operatori obligohet të pastroj sipërfaqen përreth kontejnerëve nga mbeturinat, të cilat janë hedhur nga qytetarët e pandërgjegjshëm apo janë shpërndarë përreth kontejnerëve për ndonjë arsye tjetër.

Në rast se ndonjë kontejner është i dëmtuar, operatori duhet ta lajmëroj organin mbikëqyrës.

Në rast se si pasojë e parkimit të parregullt të veturave nuk arrihet të zbrazet ndonjë lokacion i kontejnerëve, operatori duhet të lajmëroj policinë dhe të koordinohet për kohën e zbrazjes. Menaxhimi i një situate të tillë, duhet të bëhet nga menaxheri i Operatorit Ekonomik. Implikimi i organit mbikëqyrës për raste të tilla do të bëhet vetëm kur situata është e pamundur të zgjidhet nga OE.

Vërejtje:

- *Gjatë ofrimit të shërbimit, të gjithë punëtorët duhet të kenë të veshur uniformë (ngjyra e të cilës përcaktohet nga organi mbikëqyrës), jelek reflektues, helmetë (në hapësirat kur ka edhe lëvizje të automjeteve), këpuca me mbrojtëse të gishtave, dorëza pune, çizme, jakne/pelerinë. Uniforma do të përmbajë llogon e Komunës së Prishtinës në anën e dhjathtë dhe llogon e kompanisë në anën e majtë.*
- *Para fillimit të kontratës duhet të dorëzohet edhe Plani Menaxhues Operativ, përmes të cilit parashihet organizimi i makinerisë dhe punëtorëve, si dhe baza ku do të vendoset makineria.*
- *Kostot që burojnë nga ky pozicion mbuloohen nga vet OE.*
- *E gjithë makineria e shfrytëzuar duhet të jetë e pastër dhe në gjendje të rregullt.*
- *Në rast të defekteve me makineri kompania duhet të lajmëroj me shkrim organin mbikëqyrës (përmes email-it) dhe duhet të specifikoj edhe kohën kur do të rregullohet mekanizmi përkatës. Në rastet kur mekanizmi nuk mund të rregullohet apo kërkon një periudhë më të gjatë se dy ditë pune për rregullim, operatori është i obliguar të huazoj apo të blejë një makinë tjetër me karakteristika minimale si ato të përshkruar në dosje të tenderit, në të kundërtën do të shpallet i papërgjegjshëm dhe do t'i ndërpritet kontrata.*

Mbledhja e mbeturinave nga shtëpitë rezidenciale

Mbledhja e mbeturinave nga shtëpitë rezidenciale realizohet me tre llojet të makinerisë, duke pasur parasysh që kemi rrugë me gjerësi të ndryshme në qytet dhe zonë rurale, megjithëse ofrimi i këtij shërbimi kryesisht parashihet të realizohet përmes kamionëve më të vegjël (2.5-4.5ton). Ofrimi i këtij shërbimi do të realizohet në bazë të planit të pranuar minimum 12 orë paraprakisht. Ky shërbim parashihet të realizohet në dy ndërrimet e para, andaj edhe Operatori duhet të jetë i gatshëm që të ofroj makinerinë gjatë kësaj periudhe.

Pas zbrazjes së shportave (në shumë raste ekspozimi i mbeturinave bëhet me thas) operatori obligohet të pastroj sipërfaqen përreth nga mbeturinat të cilat janë shërndarë përreth.

Në rast se si pasojë e parkimit të parregullt të veturave nuk arrihet të ofrohet shërbimi në ndonjë rrugë, operatori duhet të lamëroj policinë dhe të koordinohet për kohën e kryerjes së shërbimit. Menaxhimi i një situatë të tillë duhet të bëhet nga menaxheri i Operatorit Ekonomik. Implikimi i organit mbikëqyrës për raste të tilla do të bëhet vetëm kur situata është e pamundur të zgjidhet nga OE.

Vërejtje:

- Gjatë ofrimit të shërbimit të gjithë punëtorët duhet të kenë të veshur uniformë (ngjyra e të cilës përcaktohet nga organi mbikëqyrës), jelek reflektues, helmetë (në hapësirat kur ka edhe lëvizje të automjeteve), këpuca me mbrojtëse të gishtave, dorëza pune, çizme, jakne/pelerinë. Uniforma do të përmbajë llogon e Komunës së Prishtinës në anën e dhjathtë dhe llogon e kompanisë në anën e majtë.
- Para fillimit të kontratës duhet të dorëzohet edhe Plani Menaxhues Operativ, përmes të cilit parashihet organizimi i makinerisë dhe punëtorëve, si dhe baza ku do të vendoset makineria.
- Kostot që burojnë nga ky pozicion mbulohen nga vet OE.
- E gjithë makineria e shfrytëzuar duhet të jetë e pastër dhe në gjendje të rregullt.
- Në rast të defekteve me makineri kompania duhet të lajmëroj me shkrim organin mbikëqyrës (përmes email-it) dhe duhet të specifikoj edhe kohën kur do të rregullohet mekanizmi përkatës. Në rastet kur mekanizmi nuk mund të rregullohet apo kërkon një periudhë më të gjatë se dy ditë pune për rregullim, operatori është i obliguar të huazoj apo të blejë një makinë tjetër, me karakteristika minimale si ato të përshkruar në dosje të tenderit, në të kundërtën do të shpallet i papërgjegjshëm dhe do t'i ndërpritet kontrata.

Mbledhja e mbeturinave nga bizneset

Mbledhja e mbeturinave nga bizneset realizohet me tre llojet të makinerisë, duke pasur parasysh që kemi rrugë me gjerësi të ndryshme në qytet dhe zonë rurale. Ofrimi i këtij shërbimi do të realizohet në bazë të planit të pranuar minimum 12 orë paraprakisht.

Ky shërbim parashihet të realizohet 24/7 andaj edhe Operatori duhet të jetë i gatishëm që të ofroj makinerinë gjatë gjithë kohës.

Pas zbrazjes së shportave (në shumë raste ekspozimi i mbeturinave bëhet me thas) operatori obligohet të pastroj sipërfaqen përreth nga mbeturinat të cilat janë shërndarë përreth.

Në rast se si pasojë e parkimit të parregullt të veturave nuk arrihet të ofrohet shërbimi në ndonjë rrugë, operatori duhet të lamëroj policinë dhe të koordinohet për kohën e kryerjes së shërbimit. Menaxhimi i një situatë të tillë duhet të bëhet nga menaxheri i Operatorit Ekonomik. Implikimi i organit mbikëqyrës për raste të tilla do të bëhet vetëm kur situata është e pamundur të zgjidhet nga OE.

Vërejtje:

- Gjatë ofrimit të shërbimit të gjithë punëtorët duhet të kenë të veshur uniformë (ngjyra e të cilës përcaktohet nga organi mbikëqyrës), jelek reflektues, helmetë (në hapësirat kur ka edhe lëvizje të automjeteve), këpuca me mbrojtëse të gishtave, dorëza pune, çizme, jakne/pelerinë. Uniforma do të përmbajë llogon e Komunës së Prishtinës në anën e dhjathtë dhe llogon e kompanisë në anën e majtë.

- Para fillimit të kontratës duhet të dorëzohet edhe Plani Menaxhues Operativ, përmes të cilit parashihet organizimi i makinerisë dhe punëtorëve, si dhe baza ku do të vendosen makineria.
- Kostot që burojnë nga ky pozicion mbulohen nga vet OE.
- E gjithë makineria e shfrytëzuar duhet të jetë e pastër dhe në gjendje të rregullt.
- Në rast të defekteve me makineri kompania duhet të lajmëroj me shkrim organin mbikëqyrës (përmes email-it) dhe duhet të specifikoj edhe kohën kur do të rregullohet mekanizmi përkatës. Në rastet kur mekanizmi nuk mund të rregullohet apo kërkon një periudhë më të gjatë se dy ditë pune për rregullim, operatori është i obliguar të huazoj apo të blejë një makinë tjetër me karakteristika minimale, si ato të përshkruar në dosje të tenderit, në të kundërtën do të shpallet i papërgjegjshëm dhe do t'i ndërpritet kontrata.

Larja e lokacionit të kontejnerëve

Lokacioni ku janë të vendosur kontejnerët me kërkesë të organit mbikëqyrës do të lahet (dezinfektohet). Ky dezinfektim parashihet të realizohet duke ndjekur hapat si në vijim:

- Ujitja fillestare e tërë sipërfaqe;
- Shpërndarja e detergjentit adekuat, i cili do të aplikohet për kohë të mjaftueshme në tërë sipërfaqe;
- Shfrytëzimi i brusha adekuate për shpërndarje të njëtrajtshme të detergjentit dhe depërtim të thellë të tij
- Shpëlarja e sipërfaqes duke aplikuar njëkohësisht ujë dhe duke vazhduar me shfrytëzim të brushave;
- Pastrimi përfundimtar i tërë sipërfaqes duke aplikuar ujë me presion të lartë të ujit **300-500 bar**.

Larja e lokacionit të kontejnerëve mund të realizohet edhe duke përdorur preparate tjera si rërë e thatë në presion 500bar. Kjo procedurë mund të reduktoj dukshëm hapat të cilat ndjekin deri në eliminimin e baktereve dhe yndyrave.

Larja e kontejnerëve

Kontejnerët parashihen të lahen në hapësirën (autoparkun) e vet kompanisë operuese. Larja e kontejnerëve duhet të bëhet duke shkuar zëvendësuar kontejnerët me kontejner të pastruar paraprakisht. Pra në secilën pikë/lokacion të kontejnerëve fillimisht duhet të zbrazen kontejnerët pastaj, tërhiqen së kontejnerët e papastër, vazhdohet me larje të lokacioni i kontejnerëve dhe pastaj vendosen kontejnerët e pastër. Tërheqja e kontejnerëve të papastër dhe zëvendësimi i tyre me kontejnerë të pastër duhet të realizohet në kohë optimale, respektivisht menjëherë pas pastrimit të lokacionit të kontejnerëve.

Larja e kontejnerëve duhet të realizohet me detergjent adekuat për të larguar komplet papastërtitë nga kontejneri.

Larja e kontejnerëve mund të realizohet edhe duke shfrytëzuar kamion special për pastrimin e kontejnerëve, megjithatë duhet të sigurohet një pastrim dhe dezinfektim total i kontejnerëve si në anën e jashtme ashtu edhe të brendshme.

Deponimi i mbeturinave

Pas mbledhjes së mbeturinave në bazë të planit të pranuar, Operatori Ekonomik punëkryes obligohet që kamionin t'a dërgoj për zbrastje në deponinë sanitare të mbeturinave në Mirash, të menaxhuar nga KMDK. Në bazë të vlerës sa mbeturina do të deponohen, do të paguhet edhe shërbimi në fjalë.

Mbledhja e mbeturinave pa pranimin e urdhërit nga organi mbikëqyrës nuk lejohet.

Pas deponimit të mbeturinave, kamioni duhet të sigurohet se është i pastër para fillimit të turnit në vazhdim.

Vërejtje:

- *OE është i obliguar të paguaj në rregull kostot e deponimit.*
- *OE obligohet që të gjitha raportet e pranuar mbi sasinë e deponuar t'ia dorëzoj organit mbikëqyrës.*